



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/07/24
Datë: 23.07.2024.

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/1-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut mënendë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Shpejtim Gacaferi - kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e shtatë (07) - e rregullt 2024 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 31.07.2024, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën e dytë janar-qershor 2024;
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Jashtëm për vitin 2023 dhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve;
5. Informatë mbi raportin e performancës së administratës së komunës së Junikut për vitin 2024;
6. Informatë lidhur me përfundimin e viti shkollor 2023/2024;
7. Lirimi nga detyra i anëtarit të KKSb-së z. Xhavit Gaxherri dhe zëvendësimi me anëtarin tjetër z. Gazmend Gjota në KKSb;
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit;
9. Të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/07/24
Datë: 23.07.2024 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Shpejtim Gacaferi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e shtatë (07) - e rregullt 2024 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 31.07.2024, ora 10⁰⁰.

Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën e dytë janar-qershor 2024;
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Jashtëm për vitin 2023 dhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve ;
5. Informatë mbi raportin e performancës së administratës së komunës së Junikut për vitin 2024;
6. Informatë lidhur me përfundimin e viti shkollor 2023/2024;
7. Lirimi nga detyra i anëtarit të KKSB-së z. Xhavit Gaxherri dhe zëvendësimi me anëtarin tjetër z. Gazmend Gjota në KKSB;
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit;
9. Të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 2-155/6926
Nje. Ore
Nr. i fash
Data 15/07/2024

DATE/A:	15.07.2024
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z. Xhavit Velijaj - Drejtori për Arsim, Kulturë, Rinë dhe sport (DAKRS)
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informata lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2023-2024 për institucionet edukativo-arsimore në komunë e Junikut.

I nderuar,

Duke u bazuar në planin e punës së Kuvendit Komunal, kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të KPI-së dhe në mbledhjen e Kuvendit Komunal të shtohet si pikë e rendit të ditës informata lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2023-2024 për institucionet edukativo-arsimore në komunë e Junikut.

Kjo pikë e rendit të ditës është e rëndësishme për të informuar anëtarët e kuvendit për ecurinë e vitit shkollor të kaluar, sfidat dhe sukseset e arritura, si dhe për të diskutuar mbi planet dhe përmirësimet e mundshme për vitin shkollor të ardhshëm.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport (DAKRS)

Informatë lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2023-2024, për Institucionet Edukativo-Arsimore (IEA) në komunën e Junikut

Duke u bazuar në vendimin e MASHTI për kalendarin e vitit shkollor 2023/2024, për SHFMU “Edmond Hoxha” dhe Gjimnazin “Kuvendi i Junikut”, mësimi ka përfunduar si në vijim:

- Klasat nga (1-8), me 24.06.2024;
- Klasat (9,10,11), me 06.06.2024 dhe
- Klasa e (12) me 16.05.2024.

Me përfundimin e vitit shkollor kanë përfunduar të gjitha punët administrative duke filluar me mbylljen e notave plotësimet e ditareve, njoftimi i prindërve për suksesin e nxënësve dhe raporti statistikor i suksesit.

Gjatë muajit Qershor është mbajtur testi i arritshmërisë për klasën e 9-të në bashkëpunim me Shkollën, DAKRS dhe MASHTI. Në test kanë marrë pjesë 58 nxënës, kalueshmëria ishte 97%.

Gjithashtu, në muajin Qershor për klasën e (12) është organizuar testi i maturës, në bashkëpunim me Shkollën, DAKRS dhe MASHTI. Në test kanë marrë pjesë 53 nxënës, kalueshmëria ishte 83%, ndërsa për nxënësit tjerë që nuk kanë kaluar në këtë afat, organizohet afati dytë i testit në muajin Gusht 2024.

Tabela 1. Të dhënat për numrin e fëmijëve, nxënësve, personelit administrativ, teknik dhe mësimdhënësve të përfshirë në të gjitha nivelet e IEA në komunën e Junikut për vitin 2023-2024.

Nr.	Niveli shkollor	Fëmijë	Nxënës me nevojë të veçantë	Nxënës	Mësimdhënës	Edukatore	Mësimdhënës në arsimin special	Pedagog	Asistent për fëmijë me nevojë të veçantë	Drejtor	Sekretar	Punëtor teknik	
1.	Parashkollorë 3-5 vjeç	26				2					1		
2.	Parafillor 5-6 vjeç	26				1	1		3			5	
3.	Arsimi Fillor		4	220	15			1		1			
4.	Arsimi mesëm i ulët		3	218	21								
5.	Arsimi mesëm i lartë			159	14					1			2
	Totali	57	7	591	51	3	1	1	3	2	1	6	

Tabela 2. Suksessi I nxënësve për vitin shkollor 2023/2024

Arsimi Fillor (1-5)

Komuna Junik

Shkolla fillore e mesme e ulët "Edmond Hoxha" në Junik

Klasa	Nr. Paraleleve	Nr. Nxënësve	Suksesit pozitiv						Gjithsejt me nota pozitive			Gjithsejt me nota te pamjaftueshme			Numri i mungesave			Gjithsejt												
			Shkëlqyeshëm		Shumë mire		Mire		Mjaftueshë		Gjithsejt me nota pozitive		Gjithsejt me nota te pamjaftueshme		Te pa notuara		Te arsyeshme		Te pa arsyeshme		Te mbajtura		Te pamabajtura							
			Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
1	3	42	28	16.6	5	11.9	5	11.9	2	4.67	42	95.23	0	0	0	0	702	286	988	2304	2792	12								
2	3	37	25	18.9	4	10.8	4	10.8	1	2.7	37	100	0	0	0	0	449	25	474	2307	2295	12								
3	3	39	22	23	5	12.8	5	12.8	3	7.69	39	100	0	0	0	0	402	168	570	2514	2502	12								
4	3	59	38	18.6	7	11.9	7	11.9	3	5	59	100	0	0	0	0	654	114	768	2634	2619	15								
5	3	43	18	23.3	11	25.6	11	25.6	4	9.3	43	100	0	0	0	0	626	142	768	2625	2613	12								
GJ	15	220	131	100	32	14.5	32	14.5	13	5.9	220	100	0	0	0	0	2833	735	3568	12384	12321	63								

Nota mesatare e suksesit të përgjithshëm 4.3

Tabela 3. Suksesi I nxënësve për vitin shkollor 2023/2024

Arsimi I mesëm I ulët (6-9)

Komuna Junik

Shkolla fillore e mesme e ulët "Edmond Hoxha" në Junik

Klasa	Nr. Paraleleve	Nr. Nxënësve	Suksesi pozitiv						Numri i mungesave																											
			Shkelqyeshëm		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsësi me nota pozitive		Me 1 notë të pamjaftueshme		Me 2 nota të pamjaftueshme		Me 3 nota të pamjaftueshme		Gjithsëti me nota të pamjaftueshme		Të pa notuar		Të arsyeshme		Të pa arsyeshme		Gjithsëti		Orët e planifikuara		Të mbajtura		Të pambajtura			
			Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
6	3	63	11	17.46	7	11	13	21	8	12.7	39	61.9	6	9.5	7	11	0	0	13	20.6	0	0	1739	209	1948	3185	3116	69								
7	3	50	13	30	14	28	12	24	9	18	50	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1617	174	1791	3294	3185	109									
8	3	47	8	17.02	13	28	10	21	4	8.5	35	74.4	5	11	4	8.5	3	6.3	12	12	0	0	1462	232	1694	3294	3199	95								
9	3	58	10	17.24	19	33	18	31	6	10.3	53	91.37	3	5.2	2	3.4	0	0	5	5	0	0	944	432	1376	3132	3011	121								
Gj	12	218	42	20.18	53	24	53	24	27	12.4	177	81.19	14	6.4	13	6	3	1.3	30	30	0	0	5762	1047	6809	12905	12511	394								

Nota mesatare e suksesit të përgjithshëm 3.1

Tabela 4. Suksessi i nxënëseve për vitin shkollor 2023/2024
 Arsimi i mesëm I lartë (10-12)
 Komuna Junik

Gjimnazi "Kuvendi i Junikut" në Junik

Klasa	Nr. Paraleleve	Nr. Nxënëseve	Suksesit pozitiv						Me 1 notë të		Me 2 notë të		Me 3 notë të		Gjithsejt me nota të		Gjithsejt		Numri i mungesave								
			Shkëlqyeshëm		Shumë mirë		Mire		Mjaftueshëm		Gjithsejt me nota pozitive		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Të pambajtura	Të mbajtura	Të pambajtura				
			Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%												Nr.	%	Nr.	%
10	3	53	11	21	13	25	9	14	2	3.77	35	66	4	7.54	12	23	0	0	16	30.8	2	2501	3201	170	1724	777	2501
11	3	49	16	33	11	22	13	26.5	1	2.04	41	89	1	2.04	5	10	1	2	7	14.28	1	2133	3208	146	1629	504	2133
12	3	57	19	33	13	23	8	14	3	5.26	43	75	6	10.52	6	11	1	1.8	13	22.8	1	2464	2941	533	1534	930	2464
Gj	9	159	46	29	37	23	30	18.9	6	3.77	119	75	11	6.91	23	14	2	1.3	36	22.64	4	7098	9350	8817	4887	2211	7098

Nota mesatare e suksesit të përgjithshëm 3.41



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY JUNIK

DATË/A:	12.07.2024
PËR/ZA/TO:	z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	znj.Leonora Shehu - Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Informatë mbi raportin e performancës së administratës së Komunës së Junikut për vitin 2024

Të nderuar,

Duke u bazuar në planin e punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024, përmes të cilit në muajin korrik parashihet "Informatë mbi raportin e performancës së administratës së Komunës së Junikut për vitin 2024", drejtorja për Administratë të Përgjithshme, ju informon si më poshtë:

Në Drejtorinë e Administratës, në periudhën kohore janar-qershor 2024, në tre sektorët: Sektorin për Administratë të Përgjithshme, Sektorin për Gjendje Civile dhe Sektorin Pritës, Protokoll dhe Arkivë, ka pasur mbarëvajtje të mirë të punës, punë kjo e realizuar në përputhje me Statutin e Komunës, Planin e Punës, ligjet, rregulloret, udhëzimet dhe vendimet në fuqi.

Administrata gjatë kësaj periudhe ka bërë përpjekje për transparencë dhe llogaridhënie, që të jetë sa më funksionale që shërbimet ndaj qytetarëve dhe palëve të jenë sa më efikase dhe të kënaqshme.

Në Sektorin e Gjendjes Civile për këtë periudhë kohore janë lëshuar në total 3086 dokumente, 2151 për përdorim të brendshëm dhe 935 dokumente për përdorim të jashtëm, janë kryer 22 shërbime tjera si Aktvendje, verifikime, Lirim nga Shtetësia etj.

Spektori Pritës-Protokoll ka qenë funksional dhe mjaft efikas në realizimin e lëndëve si të përfunduara, ku lëndët sipas kërkesave të qytetarëve janë vendosur

me kohë dhe brenda afateve ligjore. Në total kërkesat e parashtruara duke përfshirë të gjitha drejtoritë janë 6033.

Pas rekomandimit të drejtorisë së Administratës, Kryetari i Komunës ka marrë vendim që në muajt korrik dhe gusht 2024, Qendra për Shërbim me qytetarë të jetë funksionale 8 orë, të punojë edhe gjatë kohës së pauzës, që qytetarët të mund të marrin shërbime. Zgjatja e orarit është bërë duke u bazuar në fluksin më të madh të qytetarëve dhe që t'u ofrohet shërbim bashkëatdhetarëve.


Zyra për Arkivimin e lëndëve ka ruajtur të gjitha lëndët në mënyrë elektronike duke përdorur Sistemin për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik të Dokumenteve SMAED. Zyra e Arkivës ka qënë mjaft funksionale, ku për këtë periudhë kohore, kemi pasur gjithsej 3441 lëndë të arkivuara me 3487 dokumente të bashkëngjitura.

Kemi bërë iniciimin e procedurës së prokurimit "Zërimi i sallës së Kuvendit Komunal", ku, shumë shpejt pritet të implementohet ky projekt me rëndësi shumë madhe për mbarëvajtjen më të mirë të seancave të Kuvendit, takimeve dhe diskutimeve me qytetarë, dëgjimeve buxhetore si dhe shumë aktiviteteve të tjera në shërbim të komunitetit lokal.

Komuna e Junikut është përfutuese e projektit "EU for all" projekt i financuar nga Komisioni Europian, për qasje më të lehtë të personave me aftësi të kufizuara, në objektin e Komunës. Ku, në sajë të këtij projekti është funksionalizuar ashensori në objektin e Komunës dhe janë krijuar kushte më të mira për qasjen më të lehtë të personave me aftësi të kufizuara, siç parashihet edhe në Udhëzimin Administrativ nr.33/2007.

Sipas rekomandimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, kemi hartuar Strategjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me publikun 2024-2026.

Më respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Për/Za/To:	z. Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal në Komunën e Junikut
Përmes/Prekto/Through:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunes së Junikut, Kryesues i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
Nga/Od/From:	z. Besart Tofaj - Nenkryetar i Komunes së Junikut, Koordinator i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
Datë/Datum/Date:	10.07.2024
Tema/Subjekat/Subject:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal – lirim nga detyra dhe zëvendësimin e anëtarit në KKSB.

I nderuar,

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.06.2024 shqyrtoi dhe aprovoi dorëheqjen e anëtarit **z. Xhavit Gaxherri**. Dorëheqja e tij erdhi pasi **z. Gaxherri** përfundoi mandatin e kryetarit të Këshillit të Prindërvë në kuadër të Shkollës Fillore "Edmond Hoxha" me datë 19.04.2024.

Me datë 07.05.2024, janë zgjedhur strukturat e reja të Shkollës Fillore "Edmond Hoxha" dhe me datë 09.07.2024, kemi pranuar propozimin me kryetarin e ri të zgjedhur si përfaqësues i Këshillit të Prindërvë.

Andaj, ne e rekomandojmë **z. Gazmend Gjota** për emërim që të përfaqësoj Këshillin e Prindërvë në KKSB.

Me respekt!



REPubLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA JUNIK
 OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-06/24
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	28.06.2024
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së katër (06) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 28.06.2024, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapì dhe e udhëhoqì Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal, një përshëndetje te veçantë pati për nxënësit e Gjimnazit "Kuvendi i Junikut" dhe te gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marìn pjese te 12 antaret e kuvendit. Në mbledhje nga drejtoret prezent ishin: znj.Leunora Shehu-AD, znj.Vjollca Qestaj, z.Fatos Shala-DSHMS dhe z.Zenun Shala DUKM,z.Demokrat Ganija DSHPMSt.

Anëtarët prezent

- | | |
|--------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK |
| 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK | 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK |
| 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK | 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK |
| 4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK | 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV |
| 5. Ermelinda Lolluni - Anëtare, LDK | 14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV |
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK | 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
| 7. Leonard Lolluni - Anëtar, AAK | |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK | |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | |

z.Shpejtim Gacaferi, para se te kalojmë në rend te ditës, kemi dy kërkesa nga Kryetari i Komunës që në rend te ditës të hynë si pika këto: si pikë e 5.Njoftim mbi raportin e punës se kryetarit te komunës Janar-Qershor 2024, si dhe si pikë e 6, Shqyrtimi dhe miratimi i strategjisë për komunikim me publikun për 2024-2026, a ka dikush diçka për te shtuar?

z.Lulzim Gacaferi, përshëndetje për te gjithë, sa i përket këtyre dy pikave, unë mendoj se raporti i punës se kryetarit duhet te lihet për mbledhjen e radhës, pasi qe ne nuk kemi pasur kohë ta lexojmë këtë raport.

z.Shpejtim Gacaferi, mendoj se kur te vijmë ne këtë pikë te marrim një pauzë prej 30 minutave që të keni kohë ta lexoni raportin pastaj vazhdojmë me mbledhjen., atëherë e qes ne votim rendin e ditës te propozuar për mbledhjen e sotit me këto dy pika shtesë.

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Komizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027,
4. Informatë mbi zhvillimin e sektorit të turizmit në Komunën e Junikut,
5. Njoftim mbi raportin e punës se Kryetarit të Komunës për Janar-Qershor 2024,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i strategjisë për komunikim, dhe marrëdhëniet me publikun për 2024-2026.
7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit dhe
8. Të ndryshme

Rendi i ditës u miratua me 12 vota për. 0 vota kundër, dhe 0 vota abstenim.

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,

z.Shpejtim Gacaferi ne këtë mbledhje mungojnë, z.Zenel Maloku (AAK), z.Dervish Bajraktari (AAK) dhe znj.Festina Maloku (AAK).

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, e qes ne votim procesverbalin e mbledhjes se kaluar, kush është për? për 12 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali i mbledhjes se muajit Maj-2024 u miratua.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Komizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027,

Sqarimin dhe arsyetimin e Kornizës afatmesme Buxhetore Komunale për 2025-2027 e prezantoi znj. Vjollca Qestaj- drejtoreshë në DBF e cila fillimisht i përshëndeti të gjithë, më pas e prezantoi para anëtarëve të kuvendit KAB-in 2025-2027.

z. Leonard Lolluni. Përshëndetje për të gjithë, unë isha ndalur në faqen 20, që ka të bëjë me investimet kapitale, sepse propozimet që kanë ardhur nga dëgjimi publik nuk i kemi në këtë listë, në listën për kapitale për vitin 2025 i kemi vetëm 5 projekte dhe janë projekte që vazhdojnë nuk janë projekte të reja, nga një prej këtyre projekteve është ndërtimi i sheshit në qendër, për këtë vit kanë qenë të planifikuara 150000€ për këtë vit dhe ende nuk ka filluar asgjë të punohet në atë drejtim, dhe për këtë projekt i kemi paraparë edhe një shumë prej 50000€ për vitin 2025, projekt tjetër është hapja e rrugëve fushore lokacioni "Troje", "Shafrane" dhe "Gjocaj", këtë projekt e kemi patur edhe për vitin 2024 nuk e di se a ka filluar me këtë projekt, është projekt rehabilitimi i rrugëve lokale që është projekt vazhdues, projekti i ndriçimit publik dhe projekti vendosja e kamerave 20000€ janë parapare për këtë vit dhe 25000€ për vitin 2025, këto janë 5 projekte për vitin 2025, nuk ka projekte tjera, projektet që na i prezantoi drejtoresha që kanë dalur nga dëgjimi publik, në atë dëgjim publik kanë qenë shumica zyrtarë komunalë dhe dy ishin qytetar.

znj. Vjollca Qestaj, unë e ceku se lista e projekteve të prezantuar mund të ndryshoj, kemi me vazhduar prap me dëgjime buxhetore, projekte që kanë dalë nga dëgjimet publike nuk hynë në këtë listë tani për tani, sepse ka me vazhduar procesi i shqyrtimit të këtyre projekteve, dhe në fund pasi që të shqyrtohen dhe në bazë të prioriteteve në Shtator hyjnë në listën e kapitaleve.

z. Leonard Lolluni, për vitin 2025 vetëm për 5 projekte kemi ndarë mjete në këtë listë që na kemi prezantuar.

z. Arten Hamza, përshëndetje për të gjithë, vetëm sa për sqarim, sa i përket procesit të dëgjimit publik, kryetar me një vendim ka caktuar një komision që merret me hartimin e buxhetit, në si komision jemi duke i shqyrtuar këto projekte që kanë dalur nga dëgjimet publike dhe ende nuk kemi vendosur që ti vendosim të kaptalet apo në ndonjë kategori tjetër buxhetore plus kësaj, shumica e këtyre projekteve ende nuk dihet se sa do të jetë kostoja, jemi në fazën e shqyrtimit, KAB është dokument strategjik, deri tani kemi vetëm propozime, kurse projekte që vendosen me financim vendosen në Shtator, pajtohem me Leonardin se këto janë projekte në vazhdim, por janë projekte që kanë hyrë vitin e kaluar me vazhdim tre vjeçar për këtë arsye janë në këtë dokument strategjik mund të ndryshojnë në shtator kur kuvendi të merr vendim se cilat projekte do të hynë në buxhet për vitin 2025 dhe cilat hynë në pritje të financimit për vitet 2026, 2027, për momentin ky është vetëm dokument strategjik jo dokument buxhetor, dokument strategjik që i përmend burimet e financimit sa do të jetë buxheti edhe orientimet preliminare ku kanë me u shpërndarë këto mjete që mundet edhe me u ndryshuar me qarkoren e dytë sepse ministria e financave mundet mos me e pranuar ndonjë propozime që ne e kemi dërguar, në qarkoren e dytë mundet me ndryshuar tavanet e kategorive shpenzuese, mund të kemi rritje të kapitaleve dhe në atëherë saktësisht pas dëgjimeve publike që janë të planifikuara propozimet vendosen në kornizën afatmesme buxhetore e cila është prap pjesë e dokumentit buxhetor në shtator me të dhënat finale se cili projekt hyn në buxhet për vitin 2025.

z. Lulzim Gacaferi, përshëndetje për të gjithë, unë kam qenë prezent në dëgjime publike që u mbajtën këto ditë dhe nuk e kemi pasur të arsyeshme ta futni në atë listë propozimin tim që ka të

beje me rrugën dytësore ne lagjen “Gacafer”, tek shtëpia e Bashkim Tofës, Lul Gacaferit , po ashtu kanalizimin e ujërave te zeza ne lagjen “Bajraktar”, te shtëpia e Agim Knushit, as ata nuk e keni futur ne atë listë dhe çështja tjetër, unë jam asamblist për herë të tretë dhe qe nga viti 2017 e këndeje kjo rruga shafranc është diskutuar shumë herë dhe dua te di nga ju a jeni ka ndërtoni autostrada a çka ne atë pjesë sepse qe nga viti 2017 shumë e shumë here është duke u folur rruga “shafranc”, po ashtu ne faqe 17 rikonstruimi i “parkut Ibrahim Rugova” dhe me erdhe mirë se paskemi një park “Ibrahim Rugova sepse për herë të parë po dëgjoj për këtë park a mundem ta di për lokacioni e këtij parku? Po ashtu zërimi i asamblesë Komunale, desha ta di se kur do të ndodhe sepse kjo është mëse e domosdoshme.

z.Vjollca Qestaj, eshte e vërtet se ti ishe pjesëmarrës ne dëgjim publik, ne këtë listë janë vetëm ato propozime qe kanë dalur me datën 16.06.2024, këtu nuk janë vetëm ato propozimet e tua por edhe propozimet e te tjerëve, deri sot janë mbajtur dy dëgjime publike dhe ne këtë listë qe unë sot e przentova janë propozime e dalura nga takimi me qytetarët te datës 16.06.2024.

z.Ruzhdi Shehu, përshëndetje për te gjithë, sa për sqarim, këto projekte janë dalë si propozime ne dëgjimet e fundit me qytetarët, propozimi i rrugës dytësore ne lagjen “Gacafer” qe u propozuar nga z.Lulzim Gacaferi ajo rrugërrugçrrug vetëm gjendet ne PIP do te thotë se ekziston, ndërsa lokacioni i “parkut Ibrahim Rugova” është te objekti i lëshimeve te dokumenteve ne drejtim te lagjes “Berishë” pranë shtratit te Lumit “Erenik”.

z.Leonard Lloluni, z.Arten Hamza e përmendi se këto shuma munden te ndryshojnë, shumat që janë paraparë për këtë buxhet, për këto 5 projekte, dhe nëse në shtator na vije me rritje e këtyre shumave, unë do ta votoj buxhetin.

z.Sadri Krasniqi, përshëndetje për te gjithë, ne si grup i L.DK_së pas shqyrtimi te kornizës afatmesme buxhetore për vitin 2025-2027, ku shifet se ky planifikim ka rritje vit pas viti si ne grande qeveritare, ashtu edhe ne te hyrat vetanake ne si grup e përkrahim dhe e miratojmë këtë kornizë buxhetore, me shpresë ne punën e tuaj kryetar dhe te gjithë drejtorëve që lista e projekteve qe e kemi përpara ne vitin 2027 te jetë më e vogël.

z.Shpejtim Gacaferi, ~~kerkesekërkesë~~ tjetër nuk ka ~~meunë~~ e qes ne votim kush është për? për 10 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 2 vota, konstatoi se projekt ~~KornizaKornizaKorniza~~ Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027, u miratua.

4. Informatë mbi zhvillimin e sektorit të turizmit në Komunën e Junikut,

Informatën e beri z.Jetmir Jasiqi- drejtor ne DEZH, i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë më pas e informoj kuvendin lidhur me turizmin ne Komunën e Junikut.

z.Leonard Lloluni, unë e kam lexuar materialin dhe vetëm e përgëzoj drejtorin qe është zgjedhur drejtor ne atë drejtori, besoj se është i duhuri ne atë drejtori, dhe vetëm suksese i uroj.

z.Lulzim Gacaferi, drejtor kemi disa objekte qe i përkasin turizimit siç janë objekti ne "Livadhin e madh", objekti ne "Moronice", objekti i "Vajevices", pastaj rruga qe qonëgon ne bjeshkën e Junikut një pjese është e pa asfaltuar ne fshatin "Gjocaj" te "lagjeja e Malokëve", kur do te janë këto objekte funksionale dhe a keni informacion se çfarë po ndodhë pse nuk është asfaltuar ajo pjesë e rrugës në "Gjocaj"? Ne e dimë se si Komune i kemi te kufizuara mjetet financiare me intereson të di se a e keni marë parasysh qe këto objekte te hynë ne funksion ne mënyra tjera publiko private, qe se paku këto objekte te funksionalizohen.

z.Jetmir Jasiqi, sa i përket kullës në "Moronicë", ai objekt ende nuk është i përfunduar, punimet aty janë ndërprerë, "shtëpija bjeshkatarve" ne livadh te madh ka mendjme qe në te ardhmen te japim ndonjë kompanie qe moret me zhvillimin e Turizimit, ndërsa sa i përket mos asfaltimit te rrugës ne "Gjocaj" për momentin nuk kam informatë por për mbledhjen e radhës mund te ju informoj, po ashtu për objektin e "Vajavices" mendojmë ta japim me qera.

z.Ruzhdi Shehu, per shtëpinë e bjeshkatarëve ne livadh te madh edhe për objektin ne Moronicë por edhe objekti i vajavices komuna e Junikut nuk ka pronësi, ne e kemi dërguar elaboratin e shpronësimit te atyre parcelave ne ministrinë e ambientit dhe ne ministrinë e financave për te pasur te drejtën e shfrytëzimit kjo është ana ligjore dhe është procedurë qe zgjatë pas qe te ndodhe kjo me pas kemi te drejtën e lëvizjes për dhënien ne shfrytëzim apo te menagjohet nga komuna, ndërsa sa i përket rrugës ne Gjocaj, është ndërprerë për shkak te kontestit gjyqësor juridik qe një palë ka kundërshtuar.

5. Njoftim mbi raportin e punës se Kryetarit të Komunës për Janar-Qershor 2024,

Njoftimin mbi raportin e punës se Kryetarit te Komunës për Janar-Qershor 2024 e beri z.Ruzhdi Shehu, kryetar i Komunës se Junikut.

z.Mursel Salihaj, përshëndetje për te gjithë, deshta të di më shumë për rrugën unazore që parashihet në të ardhmen te ndodhë, rruga prej qendrës për fshatin Dobrosht a bënë pjesë edhe kjo ne atë rrugën unazore? Dhe pyetja tjetër është rruga Junik-Rastavicë si e keni planifikuar a do të ketë trotuare ne te dy anët e rrugës?

z.Ruzhdi Shchu, po rruga nga qendra ne drejtim te fshatit Dobrosht te udhëkryqi do të jetë pjesë e asaj unazës se qendrës, ndërsa sa i përket rrugës Junik-Rastavicë po do te ketë trotuare nga lagjeja "Agim Ramadani," por do te ketë edhe ndriçim publik.

z.Lulzim Gacaferi, me qen se projekti për qendër është ne proces do te ishte mirë që ky projekt kur te përfundoj ne si asamblist ta kemi ketë projekt.

znj.Rajmonda Krasniqi, sa i përket dëgjimeve publike me parë që u cckë nga kryetari me sa pashe ai takim ka qenë më i hareshëm sepse ketë vit ende nuk është mbajr.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka kalojmë ne pikën e gjashtë të radhës.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i strategjisë për komunikim dhe marrëdhëniet me publikun për 2024-2026.

Sqarimin dhe arsyetimin e strategjisë e beri znj. Leunora Shehu, e cila fillimisht ju kërkoj të falur për vonesën e dërgimit të dokumentit për këtë strategjinë dhe pasi që i përshëndeti të gjithë e sqaroi dhe e arsyetoi para anëtarëve të kuvendit, strategjinë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për 2024-2026.

z. Lulzim Gacaferi, është për të ardhur keq që na sillni me vonesë një dokument të tillë e që ne nuk kemi kohë as ta lexojmë, e ne fund kërkohet miratim nga ne, këtë strategji e ka pasur edhe kryetari paraprak dhe unë si asamblist s' di sa here e kam lëshuar seancën, kërkoj nga ju që ne të ardhmen mos të bëni këso gjërash përndryshe nuk e kemi mbështetjen tonë.

z. Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka e qes ne votim, strategjinë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun, procent në sallën e kuvendit janë 11 anëtarë të kuvendit, kush është për? për 10 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 1 votë, konstatoi se strategjia për komunikim dhe marrëdhënie me publikun 2024-2026 u miratua.

7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit

z. Shpejtim Gacaferi, pyetje nuk ka kalojmë në pikën e fundit.

8. Te ndryshme.

z. Lulzim Gacaferi. Me qenëse është prezent drejtori i urbanizmit z. Zenun Shala, dua të ngrit si çështje punimet që janë duke ndodhur në rrugën Junik-Rastavicë, në ishëm një ditë në lagjen "Miroc", dhe vërejtëm se punimi i kubëzave nuk është d ka bchet në mënyrën profesionale, ka mungesë të gjeotekstit, dëmtim të anësoreve mbi 75% të atyre që ne i kemi numëruar janë të dëmtuara, dhe unë dua të di nga ju a keni menduar të bëni inspektim të këtyre punimeve me stafin e juaj, dhe më sqaroni si keni mundur ta bëni menaxher të këtyre punimeve një zyrtar që nuk është adekuat me profesion, unë kërkojë nga ju dhe kryetari që sa më shpejt që të jetë e mundur ta dërgoni një staf profesional të largoj ato anësoret o dëmtuara dhe të vendoset gjeotekstili nën kubëza për shkak se është obligative, po ashtu ka edhe ngushtim të trotuarit, sepse në kontratë trotuari parashihet të jetë 2 metër i gjerë.

z. Zenun Shala, përshëndetje për të gjithë, projektin e riparimit të rrugës Junik-Restavicë e kemi marrë ne, por për caktimin e menaxherit të kësaj kontrate, ju e dini se komuna e Junikut ka mungesë të inxhinjerave të kësaj lëmieje, gjatë vlerësimit të tenderit ne kemi pasur një inxhinier të kësaj lëmieje dhe me pas nuk kemi pasur mundësi ligjore që të njëjtin ta kemi edhe menaxher të kontratës sepse ligjet e prokurimit nuk e lejojnë këtë për këtë arsye e kemi angazhuar inxhinierin e IT si menaxher të kontratës, projekti po ashtu ka mangësi tjerë siç është ajo e gjeotekstit ku parashih vetëm 4500m të kete, a ne pergjegësi janë 8800m kubzakubëza, sipas projektuesi ai ka parapareparaparë të keteketë gjeotekstil vetëm aty ku ka rrjedhje të ujit, kështu që operatori

ekonomik është duke vepruar ashtu siç e ka paraparë projektuesi, ndërsa sa i përket anësoreve të dëmtuara operatori ekonomik na ka thënë se do të ndërroj të gjitha anësoret që janë të dëmtuara.

z.Lulzim Gacaferi, operatori ekonomik që është duke kryer këto punime i ka ikur asaj ku vendosen shtyllat e ndriçimit në projekt janë katrore, unë them që projekti ka një shumë të madhe dhe do ishte mirë ta merrni një kompani për mbikëqyrje dhe jo zyrtar të IT, përndryshe kjo vlenë edhe për kryetarin tonë na bëni që ne të ngrisim këtë çështje edhe në senaca juridike.

z.Leonard Lolluni, unë kam dy qeshtje, çështja e parë ka të bëjmë me vendosjen e kamerave, ne hyrjen në Junik nga ana e Vokshit, ai lokacion është në gjendje të mjerueshme nga hedhja e mbeturinave, me sa jame në dijeni këtë nuk e bëjnë qytetaret e Junikut por qytetaret e zonave për rreth, dhe nëse vendosni një ~~kamernjç kamerë~~ kamerë në atë pjesë ~~do të shihet se kush po hedhë mbeturina.~~

znj.Lirjeta Shehu, përshëndetje për të gjithë, meqë është ~~prezen~~prezent drejtori i shëndetësisë z.Fatos Shala, desha me ditë a është në dijeni se në QKMF nuk ka ~~bebi~~ sistem dhe as kanil, dy sene që janë elementare që duhet të ~~ketenjeketë~~ një QKMF, ne dimë se QKMF ja funksionon 24 ~~ore~~orë çka nëse një pacient shkon pas mesnate nuk ka as ku të blej sepse nuk ka as barnatore që është hapur, dhe përpos kësaj nëse ka raste ~~urgjenturgjente~~ ta vendosin kanellën ama familjarët e pacientit mas 5 minutave duhet të shkojnë ta blejnë kanellën dhe ta sjellin në QKMF, kjo me duket se nuk është në rregull.

z.Fatos Shala, përshëndetje për të gjithë, është e vërtetë që nuk ka mjaftueshëm, por në fillim kemi pasur ndalesa nga niveli qendror sepse në QKMF është e ndalura të ketë shtrirje si në spital të pacientëve dhe për këtë arsye kemi pasur furnizim të mangët nga qendra dhe duke i shtuar kësaj edhe vizitat e shumta të qytetarëve nga komunat për rreth atëherë është mese e vërtetë se ka mungesa të këtyre dy pajisjeve, tani jemi në fazën e tenderimit dhe në e kemi rritur e këtyre sistemeve dhe të kanellës.

z.Lulzim Gacaferi, desha të ndërlidhem edhe unë me çështjen e shëndetësisë, në si familje kemi patur këto ditë një rastë dhe QKMF ja na udhëzojë për në Gjakovë dhe na u deshtë autoambulanta në autoambulante ishte she stafi përcjellës dhe unë i falënderojë nga këtu këtë staf por ajo që më beri përshtypje negative ishte se ~~autoambulanta~~autoambulanca nuk kishte klimë dhe udhëtimi i pacientit deri në spital e vështirësuar, a e keni këtë informatë se klima në autoambulancë nuk funksionon.

z.Fatos Shala, jo unë nuk e ~~kam~~kam këtë informatë dhe sot do të merrem me këtë çështje.

z.Lulzim Gacaferi, po ashtu stafi aty u ankua se pagesat për orët shtesë nuk janë duke u paguar, dhe me është thënë se kryetari i Komunës ka mbajtur mbledhje me ta dhe se u është premtuar se kujdestaria dhe orët shtesë do të ju paguhet.

z.Ruzhdi Shehu, kjo nuk qëndron sepse ata nuk e arrijnë numrin e orëve mbi 40 orë pune.

znj. Rajmonda Krasniqi, edhe kjo çështje ka të bëjë me shëndetësinë, ka dy vite që ka mungesë të paisjeve laboratorike, memogram nuk ka, unë kam dashtur t`ja beje vajzës pasqyrën e gjakut dhe me kanë thënë se të gjitha analizat i bëjmë, këtë analizë nuk e bëjmë është viti i dytë që kjo analizë nuk behet në QKMF-Junik.

z. Fatos Shala, paisja që bëhet mamogramin quhet "Humane", dhe është paisje e re që e kemi blerë, një periudhë nuk e kemi pasur këtë paisje, pastaj furnizimin e kësaj paisje pasur në procedura të prokurimit deri sa është bërë furnizimi me reagjenca nuk ka pasur mjaftueshëm për shkak të buxhetit, këtë herë është i futur në buxhet furnizimi me reagjenca për këtë paisje dhe hedhet në proces të prokurimit.

z. Lulzim Gacaferi, e kam edhe një çështje, për drejtorin e Administratës, drejtoreshë unë e di se nuk është detyrë e juaj të shkoni kush len dritat ndezur apo klimat, por punëtorët i keni të pa përgjegjshëm sepse ikin në shtëpi pas përfundimit të punës dhe i lajnë dritat ndezur, dhe çështja tjetër është për shërbimet publike për njësitin e zjarrfikësve, keni mangësi me personel, tjetra është një automjet që nuk funksionon a keni parë të arsyeshme që ta shtoni personelin dhe ta riparoni këtë automjet dhe çështja tjetër është se të dy zjarrfikësit nuk posedojnë patentë për ngasjen e kategorive të renda të automjeteve.

znj. Eunora Shehu, sa i përket automjetit në si administratë e kemi marrë një kërkesë për servisim të atij automjeti, deri tash ka funksionuar dhe tash do ta bëjmë servisimin e tij.

z. Shpejtim Gacaferi, e shpalli të mbyllur mbledhjen e Qershorit-2024

Procesmbajtësi:
Kuvendit:
z. Esat Hoxha

Kryesuesi i
z. Shpejtim Gacaferi



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



DATE/A:	12.07.2024
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	znj. Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e KPF-së dhe Kuvendit Komunal raportin financiar Janar-Qershor për vitin 2024

I nderuar,

Në bazë të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr: 03L/048 neni 45, paragrafi 45.4 ku është detyrë e Egzekutivit që në periudha tremujore dhe vjetore të raportoj para Kuvendit Komunal, atëherë kërkojmë që të shtohet në rend dite në mbledhjen e ardhshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, raporti financiar mbi Buxhetin dhe Shpenzimet për periudhën Janar- Qershor 2024.

Të bashkangjitur në kërkesë keni raportin e përgatitur nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF
KOSOVO



KOMUNA E JUNIKUT
OPSTINA JUNIK/ MUNICIPALITY OF JUNIK

KOMUNA E JUNIKUT

**RAPORTI I BUXHETIT
KOMUNAL PËR
PERIUDHËN JANAR -
QERSHOR / 2024**

Junik, Korrik -2024

KOMUNA E JUNIKUT

DREJTORIA PËR BUXHIET DHE FINANCA
Telefon : +381 390 370 112, Ceatres: 0008 200/44-504

Informata -II- Financiare Periodike 2024

Kërkesat për raportim

Informata Financiare Komunale për periudhën Janar – Qershor 2024, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 46.1 dhe 46.2 të Ligjit Nr. 03/L-048 “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” dhe statutit Komunal.

Informata Financiare Komunale Periodike ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrethën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë. Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesve do të prezantohet për 14 programet buxhetore :

1. Zyra e Kryetarit
2. Kuvendi Komunal
3. Administrata e Përgjithshme
4. Buxhet dhe Financa
5. Zhvillim Ekonomik
6. Shërbimet publike dhe Inspeksion
7. Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis
8. ZKK (Zyra Komunale për Komunitete)
9. Shëndetësi
10. Mirëqenie Sociale
11. Shërbimet e kujdesit primar
12. Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
13. Arsimi i mesëm
14. Arsimi fillor

TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik) të bazuar në para të gatshme “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”. Shënimet në pasqyrat financiare paraqesin pjesë integrale për ta kuptuar pasqyrën, andaj duhet të lexohen së bashku me pasqyrat.

Pasqyrat financiare janë për Komunën e Junikut. Komuna e Junikut kontrollohet nga Qeveria e Kosovës dhe të gjitha aktivitetet e saja financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Komuna e Junikut nuk operon me llogarinë e vet bankare. Qeveria operon me funksion të centralizuar të Thesarit i cili e administron pranimin e parave të gatshme të mbledhura nga të gjitha entitetet buxhetore gjatë vitit financiar. Pagesat e bëra në këtë llogari sa i përket Komunës së Junikut janë të paraqitura në kolonën e llogarisë së vetme të Thesarit në Pasqyrën e Pranimeve dhe pagesave të Parave të Gatshme.

Buxheti i aprovuar në Asambleenë Komunale për vitin 2024 është në vlerë **2,199,836.93€** i cili ka pësuar ndryshime gjatë periudhës Janar – Qershor 2024 për të hyrat nga donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2023 në vlerë **2,469.85€**, Bartja e te hyrave të pashpenzuara të vitit 2023 të bartura për shpenzim në vitin 2024 në shumë prej **147,963.74€** Buxheti përfundimtar i përgjithshëm duke përfshirë edhe donacionet është në vlerë **2,350,270.52€**.

Raport i ekzekutimit të Buxhetit

	Buxheti fillestar	Buxheti Aktual	Pranimet - Alokimet	Pagesat (Shpenzimi)	Progresi me plan	% me alokim
Përshkrimi	Ligji Nr. 08-L-260	SIMFK	SIMFK		në, %	në, %
a	b	c	d	e	f=c/e	g=c/d
Gjithsej Pagesat	1+2+3+4+5	1+2+3+4+5	1+2+3+4	1+2+3+4+5		
Totall	2,199,836.93	2,350,270.52	1,544,698.06	898,338.51	38.22%	58.18%
Paga dhe Meditje	1,445,892.93	1,445,892.93	773,878.94	754,782.12	52.20%	97.53%
Mallrat dhe Shërbimet	246,660.00	284,361.80	281,076.80	104,433.61	36.73%	37.15%
Shpenzimet Komunale	38,500.00	38,500.00	38,500.00	21,199.24	55.06%	55.06%
Subvencione dhe Transferet	62,000.00	62,400.00	42,635.79	4,168.04	6.68%	9.78%
Investimet Kapitale	406,784.00	519,115.79	408,606.53	13,755.50	2.65%	3.37%
Granti i Përgjithshëm	1,991,780.93	1,991,780.93	1,319,766.94	894,413.98	44.91%	67.77%
Paga dhe Meditje	1,445,892.93	1,445,892.93	773,878.94	754,782.12	52.20%	97.53%
Mallrat dhe Shërbimet	241,660.00	241,660.00	241,660.00	100,909.08	41.76%	41.76%
Shpenzimet Komunale	38,500.00	38,500.00	38,500.00	21,199.24	55.06%	55.06%
Subvencione dhe Transferet	30,000.00	30,000.00	30,000.00	3,768.04	12.56%	12.56%
Investimet Kapitale	235,728.00	235,728.00	235,728.00	13,755.50	5.84%	5.84%
Rezerva	2	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Investimet Kapitale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Të hyrat vetanake	3	208,056.00	208,056.00	74,497.53	0.10%	0.27%
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet	5,000.00	5,000.00	1,715.00	201.73	4.03%	11.76%
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet	32,000.00	32,000.00	12,235.79	-	0.00%	0.00%
Investimet Kapitale	171,056.00	171,056.00	60,546.74	-	0.00%	0.00%
Mjetet e bartura	4	-	147,963.74	147,963.74	3,722.80	2.52%
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet	-	37,684.30	37,684.30	3,322.80	8.82%	8.82%
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet	-	400.00	400.00	400.00	100.00%	100.00%
Investimet Kapitale	-	109,879.44	109,879.44	-	0.00%	0.00%
Grantet - Donacionet	5	-	2,469.85	2,469.85	-	0.00%
Paga dhe Meditje	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Mallrat dhe Shërbimet	-	17.50	17.50	-	0.00%	0.00%
Shpenzimet Komunale	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Subvencione dhe Transferet	-	-	-	-	#DIV/0!	#DIV/0!
Investimet Kapitale	-	2,452.35	2,452.35	-	0.00%	0.00%

Gjatë këtij gjashtëmujori të vitit 2024 ka ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe aktual siç janë: Transferi i donacioneve në shumë totale 2,469.85 €, prej tyre 260.98 € nga UN-HABITAT janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale, 17.50 € nga KOSTT në kategorinë Mallra dhe shërbime, 356.50€ nga SAVE THE CHILDREN janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale, 1,834.87€ nga DEMOS dhe SIDA janë bartur në kategorinë e investimeve kapitale .


Transferi i të hyrave të pashpenzuara të vitit 2023 të bartura për shpenzim në vitin 2024 në shumë prej **147,963.74 €**, prej tyre: 37,684.30€ Në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, 400.00€ Në kategorinë e Subvencioneve dhe transfereve dhe 109,879.44€ Në kategorinë e investimeve kapitale.

TË HYRAT BUXHETORE 2024

Pasqyra aktuale Buxhetore 2024, si dhe pasqyrat finale buxhetore për vitet paraprake

Tabela - 2

Burimi i mjeteve	Pranimet 2021	Pranimet 2022	Pranimet 2023	Pranimet 2024	Progresi 24/23	Progresi 24/22
1	2	3	4	5	7=5/4	8=5/3
Grandi Qeveritar	1,454,591.93	1,509,481.36	1,720,090.49	1,991,780.93	115.80%	131.95%
Të hyrat vetanake	122,802.00	159,038.00	159,330.00	208,056.00	130.58%	130.82%
Mjetet e Bartura	31,830.15	91,915.99	195,144.42	147,963.74	75.82%	160.98%
Donacionet	2,469.85	2,469.85	2,469.85	2,469.85	100.00%	100.00%
Gjithsej	1,611,693.93	1,762,905.20	2,077,034.76	2,350,270.52	113.16%	133.32%




TË HYRAT PERIODIKE NGA GRANTI I QEVERISË

Klasifikimi ekonomik	2024	2023	2022	2021
	BKK	BKK	BKK	BKK
	€'	€'	€'	€'
Pagat dhe rrogat	1,445,892.93	1,172,980.49	1,164,539.36	1,153,888.93
Mallrat dhe shërbimet	241,660.00	232,840.00	196,580.00	166,900.00
Shërbimet komunale	38,500.00	37,700.00	36,200.00	36,200.00
Subvencionet dhe transferet	30,000.00	20,000.00	20,000.00	-
Shpenzimet kapitale	235,728.00	256,570.00	92,162.00	73,003.00
	1,991,780.93	1,720,090.49	1,509,481.36	1,429,991.93

TË HYRAT VETANAKE PERIODIKE 2024


Përveç Grandeve të marra nga niveli qendror, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka grumbulluar edhe të hyra vetanake. Ekzistojnë disa kategori kryesore të hyrave vetanake komunale: Tatimi në pronë, Te hyrat nga Shëndetësia, Te hyrat nga Regjistrimi i Automjeteve etj.... Të hyrat totale vetanake të grumbulluara Janar - Qershor 2024 kanë arritur në shumën prej **81,043.79 €** që përbën **38.95%** të planifikimit vjetor (**208,056,00€**).

GRAFIKONI I TË HYRAVE VETANAKE PËRIODIKE 2021 - 2024



Të hyrat vetanake kryesore periodike Janar – Qershor 2024

Te Hyrat nga	Realizimi 2021	Realizimi 2022	Realizimi 2023	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Progresi me plan	Progresi me /2023	Progresi me /2022	% në total
	1	2	3	4	5	6-5/4	7-5/3	8-5/2	7-5/total
Tatimi në pronë	51,178.33	54,931.90	73,808.91	127,505.00	55,651.17	44%	75%	101%	68.77%
Te hyrat nga Shëndetsia	1,787.00	1,883.50	1,703.50	8,000.00	2,010.00	25%	118%	107%	2.8%
Te hyrat nga Administrata	2,440.00	3,070.50	3,057.00	8,000.00	2,849.00	36%	93%	93%	3.5%
Regjistrimi i Automjeteve	3,110.00	3,849.50	4,681.00	8,000.00	4,960.00	62%	106%	129%	6.1%
Te hyrat nga Gjobat ne trafik	915.00	1,157.50	3,430.00	-	1,825.00	#DIV/0!	53%	158%	2.3%
Te hyrat nga lejet per ushtrim te veprimtarise	2,861.00	4,731.66	9,562.25	15,000.00	5,105.00	34%	53%	108%	6.3%
Te hyrat nga Urbanizimi	4,594.00	4,648.08	5,018.00	32,001.00	6,610.62	21%	132%	142%	8.2%
Të hyrat tjera	3,125.00	190,387.25	1,668.00	9,550.00	2,033.00	21%	132%	142%	2.5%
Totali	70,010.33	264,659.89	102,928.66	208,056.00	81,043.79	39%	79%	31%	100%



Ne kategorinë Të hyrat tjera bëjnë pjesë: (Të hyrat nga Qiraja 00.00€, Të hyrat nga shërbimet publike-inspeksioni 2,033.00 €) gjithsejtë **2,033.00€**

Periudha Janar - Qershor 2024 karakterizohet me një realizim të të hyrave në total 81,043.79 € apo 38.95% në raport me planifikimin vjetor, ndërsa krahasuar me vitin paraprak 2023 kemi realizuar 78.74% apo 21.26% më pak, shprehur në vlerë monetare diferenca është 21,884.87 € më pak.

Ne këtë raport nuk janë të përfshira të hyrat nga gjobat e trafikut për periudhën Prill-Qershor 2024 pasi që nuk janë alokuar akoma.


SHPENZIMET BUXHETORE 2024

Planifikimi Buxhetor për 2024 duke përfshirë edhe donacionet është **2,350,270.52€**, gjatë kësaj periudhe janë alokuar mjete në vlerë **1,544,698.06€** ndërsa janë shpenzuar **898,338.51€**, apo **58.16%** e buxhetit të alokuar.

Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike.

Nr	Përshkrimi	2021	2022	2023	2024	Alokimet TM2/24	Progresi %	
							8-6/5	9-6/7
1	Pagat					773,878.94	102.65%	97.53%
2	Mallra e shërbime	573,115.36	519,720.91	735,326.30	754,782.12	281,076.80	167.78%	37.15%
3	Shpenzi komunale	66,434.05	128,413.80	62,245.37	104,433.61	38,500.00	130.16%	55.06%
4	Subvencione	12,577.39	18,386.41	16,287.37	21,199.24	42,635.79	362.44%	9.78%
5	Shpenzi Kapitale	8,550.00	16,998.95	1,150.00	4,168.04	408,606.53	8.03%	3.37%
	Total	300,676.80	744,964.19	986,244.04	898,338.51	1,544,698.06	91.09%	58.16%

GRAFIKONI SHPENZIMEVE DHE % EPJESMARRJES NË SHPENZIMET



- Pagat dhe mëditjet të alokuara në vlerë 773,878.94€ janë shpenzuar 754,782.12€ apo 97.53% e mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak shpenzimi në këtë kategori është më i lartë për 2.65% për shkak ndikimit të ndryshimeve pas hyrjes në fuqi të ligjit të buxhetit për vitin 2024 rritja e vlerës së koeficientit të pagave. Pjesëmarrja e pagave në shpenzimin e përgjithshëm Komunal është 84.02%.
- Mallrat & shërbimet të alokuara në vlerë 281,076.80€ janë shpenzuar 104,433.61€ në përqindje 37.15% e mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 67.78%. Pjesëmarrja e Mallrave & Shërbimeve në shpenzimin e përgjithshëm Komunal është 11.63%.
- Shpenzimet komunale - Komunalit të alokuara në vlerë 38,500.00€ janë shpenzuar 21,199.24€ ose në shkallën prej 55.06% të mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 30.16%. Pjesëmarrja e shpenzimeve komunale në shpenzimin total komunal është 2.36%.
- Subvencionet të alokuara në vlerë 42,635.79€ janë shpenzuar 4,168.04€ ose në shkallën prej 9.78% të mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të larta për 262.44%. Pjesëmarrja e shpenzimeve të subvencioneve në shpenzimin total komunal është 0.46%.
- Shpenzimet kapitale të alokuara në vlerë prej 408,606.53€ janë shpenzuar 13,755.50€ ose në shkallën prej 3.37% të mjeteve të alokuara. Krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime më të ulëta për 91.97%. Pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në shpenzimin total komunal është 1.53%.
- Në total mjetet e alokuara për periudhën gjashtëmujore të vitit 2024 në vlerë prej 1,544,698.06€ janë shpenzuar në vlerë prej 898,338.51€ ose në shkallën 58.16% të mjeteve të alokuara, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 shpenzimet janë më të ulëta për 8.91%.

RAPORTI DETAL I SHPENZIMEVE NË PAGA, MALIA & SHËRBIME SIPAS DREJTORIVE

Përsëkrimi	Z. Kryetarit	Administrata	Zh. Ekono.	Sh. Publike	K. Komunal	B. Financa	Urbanizem
Paga neto	32,179.81	35,117.77	22,711.25	24,167.07	48,605.92	27,383.52	20,954.82
Tatimi në pagu	3,117.63	1,795.87	1,524.20	1,852.78	3,823.79	1,874.90	1,556.48
Kontributi pensional i punetoreve	1,888.89	2,073.94	1,349.07	1,433.40	3,267.24	1,596.84	914.94
Sindikatat							
Odat Profesionale							
Pervoja e punes	1,429.45	1,331.02	621.01	802.54	185.36	1,081.10	1,146.80
Kontributi pensional i Punëdhënësit	1,888.89	2,073.94	1,349.07	1,433.40	3,267.24	1,596.84	914.94
Shtesa e veçant për të zgjedhurit							
Kujdestaria, puna jasht orarit të punes, puna	2,116.25	823.35	776.36	411.89	9,458.64		
Shtesa Tranzitore	1,855.59	354.95					
Vendim gjyqate	-						
TOTALI I PAGAVE & MEO.	44,476.51	43,550.84	28,330.96	30,101.08	68,608.19	33,533.20	24,587.98
Shpenzimet e udhimit në vende	-						
Shpenzimet e udhet. Jashtë Vendlit		1,027.30	52.00	85.15		85.15	
Shpenzimet e internetit	-						
Telefonia Mobile	406.76	390.58	144.00	217.15		35.00	
Shërbimet Postare		161.00				425.29	203.42
Shërbimet e perfaqësimit avokatur		3,495.00					
Shërbimet e ndryshme Shëndetsore							
Shërbimet e veqanta - konsulent dhe kontrakt	600.94	3,921.70					
Shërbime shtypje / printimit	115.73	373.14	23.43	65.76		1,000.00	5,401.20
Shërbime kontraktuese tjera						295.88	89.87
Shërbime teknike	-	160.00					
Shpenzimet per anëtarësim	912.60						
Mobile me pak se 1000€							
Kompjuterë me pak se 1000€							
Makina fotokopjuese							
Pajisje trafiku me pak se 1000€							
Pajisje tjera me pak se 1000€	86.00						
Pajisjet specialistike mjeksore						142.00	
Furnizim i Zyres		610.00					
Furnizim me ushqim dhe pije	430.69	56.04	71.08	95.25		138.59	
Furnizimet mjeksore							
Furnizim e pastrimit							
Shpenzimet e veshmbathjes							
Akomodimi							
Nafta për ngrohje		2,661.68					
Dru dhe prodhimet e drurit per ngrohje							
Derivate për automjete, Gjenerator dhe makina	1,220.71	594.46	32.59	1,513.59		381.61	151.72
Avans për para të imet (patty cash)		500.00					
Regjistrimi dhe sig.automjeteve		418.79					
Sigur. I ndërtesave dhe të tjerave		280.00					
Mirëmb. dhe riparim i automjeteve				274.40			
Mirëmbajtja e monumenteve dhe komplekseve				921.00			
Mirëmbajtja e ndërtesave				8,640.00			
Mirëmbajtja e rrugëve lokale							
Mirëmb. e teknologjisë informatike							
Mirëmbajtja e mobileve&pajisjeve		900.00					
Mirëmbajtja rutimore							
Qiraja							596.50
Reklamën dhe konkurset							1,100.00
Botime dhe publikime			2,000.00				
Kompensim i perfaqësimit brenda vendit	392.50	600.00	111.50	400.00			
Vendim gjyqate						384.50	86.00
Pagesa Per Tarifa - Vendime gjyqore permab						34.22	
Pag.neni 39.2 LMFPP							
TOTALI M & SH	4,165.93	16,152.69	2,434.58	12,212.30	-	2,922.24	7,628.71

RAPORTI DETAL I SHPENZIMEVE NË PAGA, MALLA & SHËRBIME SIPAS DREJTORIVE

Përshkrimi	Ad. Arsim	Ars. fillor	A. i njesem	Ad. Shendet.	QKMF	Sh. Sociale	ZLK	Totali periodik 2024
Paga neto	14,558.07	153,250.29	57,760.15	6,675.14	113,081.79	5,109.48	3,265.86	563,920.94
Tatimi në paga	1,105.17	10,596.21	4,081.22	559.92	8,792.38	301.98	228.48	41,211.01
Kontributi pensional i punëtorëve	850.40	9,017.05	3,451.05	405.76	6,782.05	297.00	190.38	33,518.01
Sindikatat		467.67	203.90					671.57
Ëdat Profesionale					1,129.35			1,129.35
Përvoja e punës	494.36	6,513.43	3,031.24	473.90	5,394.41	230.82	122.52	22,857.96
Kontributi pensional i Punëdhënësit	850.40	9,017.05	3,451.05	405.76	6,782.05	297.00	190.38	33,518.01
Shtesa e veçant për të zgjedhurit								9,458.64
Kujdestaria, puna jashtë orarit të punës, puna		490.20	489.81					5,569.74
Shëresa Tranzitore					461.88			2,190.54
Vendim gjykatë								40,736.35
TOTALI I PAGAVE & MED.	17,858.40	219,732.08	62,824.59	8,520.48	142,423.91	6,236.28	3,997.62	754,782.12
Shpenzimet e udhimit në Vendë								-
Shpenzimet e udhët. Jashtë Vendit		1,027.30						2,380.90
Shpenzimet e internetit	12.99	25.98				104.00		73.97
Telefonia Mobile	60.52	187.10	170.80	106.11	98.09			2,409.82
Shërbimet Postare								161.00
Shërbimet e përfaqësimit avokatur								3,495.00
Shërbimet e ndryshme Shëndetsore								105.00
Shërbimet e veçantë - konsulent dhe kontrakt	745.10	1,000.00			105.00			47,177.24
Shërbime shtypje / printimit	67.82	134.78	240.96		34,508.30			1,407.37
Shërbime kontraktuese tjera		7,866.00						7,866.00
Shërbime teknike								160.00
Shpenzimet për anëtarësim								912.60
Mobile me pak se 1000€			1,404.00					1,404.00
Kompiutere me pak se 1000€								-
Makina fotokopjuese								-
Pajisje trafiku me pak se 1000€								-
Pajisje tjera me pak se 1000€								-
Pajisjet specialistike mjeksore			62.50					290.50
Furnizim i Zyres					960.00			960.00
Furnizim me ushqim dhe pije								610.00
Furnizimet mjeksore			95.32					886.95
Furnizim e pastrimit					3,674.53			3,674.53
Shpenzimet e veshmbathjes								-
Akomodimi								-
Nafta për ngrohje								-
Dru dhe prodhimet e drurit për ngrohje								2,664.68
Derivate për automjete, Gjenerator dhe makina	493.81	617.56			1,412.48			-
Avans për para të imet (party cash)				250.00				6,418.53
Regjistrimi dhe sig.automjeteve								750.00
Sigur. i ndërtesave dhe të tjerave					338.10			756.89
Mirëmb. dhe riparim i automjeteve								-
Mirëmbajtja e monumenteve dhe komplekseve								554.40
Mirëmbajtja e ndërtesave								-
Mirëmbajtja e rrugëve lokale			187.50					187.50
Mirëmb. e teknologjisë informatike								8,640.00
Mirëmbajtja e mobileve&pajisjeve								-
Mirëmbajtja rutinore								900.00
Qiraja								596.50
Reklamat dhe konkurset								1,100.00
Botime dhe publikime								2,000.00
Kompensim i përfaqësimit brenda vendit	803.01	2,157.50						-
Vendim gjykatë								4,935.01
Pagesa Per Tarifa - Vendime gjyqsore perimb								-
Pag. neni 39.2 i MFPF								34.22
TOTALI M & SH	2,183.25	13,016.22	2,161.08	356.11	41,096.50	104.00	-	104,433.61

SHPENZIMET ANALITIKE KOMUNALIVE, SUBVENCIONEVE DHE INVESTIMEVE KAPITALE

Përshkrimi	Z. Kryetarit	Administrata	Zh. Ekono.	Sh. Publike	K. Komunal	R. Financa	Urbantem
Shpenzimet e energjisë elektrike		3,225.19	63.02	5,254.54	-	-	-
Shpenzimet e Ujjet		72.44	39.79	293.79	-	-	-
Shpenzimet e Mbeturinave		-	-	2,124.00	-	-	-
Shpenzimet e Ngrahjes		-	-	-	-	-	-
Shpenzimet Telefonike	79.29	27.00	-	197.88	-	-	-
Pagesa Vendime gjyqsore		-	-	-	-	42.72	-
TOTALI KOMUNALËVE	79.29	3,324.63	102.81	7,870.21	-	42.72	-
Subvencionet per entitetet publike							
Subvencionet per entitetet jopublike	4,168.04						
TOTALI SUBVENCIONEVE	4,168.04						
Ndërtesa te banuara							
Objekte Arsimore							
Objektet kuturore							
Objektet shendetesore							
Auto Rrugëve							
Rrugët Lokale							
Trotuarët			6,207.00				
Kanalizimi							
Ujësjetësi							7,548.50
Furniz Rrymë							
Pajisje speciale mjeksore							
Pajisje tjera							
Mirmbajtja investive							
automjete transporti (autoambulanca)							
Transaksione Kapitale - enti. Publ.							
Pag. neni 39.2 LMFP							
Vendim gjykatë							
TOTALI INVESTIMEVE			6,207.00				
TOTALI PËRGJITHSHËM	52,089.77	63,028.16	37,075.35	50,183.59	60,608.13	36,498.16	39,765.19

Përshkrimi	Ad. Arsian	Ars. fillor	A. i mesem	Ad. Shendet.	OKMF	Sh. Sociale	ZLK	Totali periodik 2024
Shpenzimet e energjisë elektrike		1,816.54	978.23		2,428.14	828.94		14,594.60
Shpenzimet e Ujjet		533.10	455.34		205.32	25.12		1,624.90
Shpenzimet e Mbeturinave		588.00	588.00		882.00			4,182.00
Shpenzimet e Ngrahjes								
Shpenzimet Telefonike		150.02	87.94					
Pagesa Vendime gjyqsore					128.80	84.09		797.74
TOTALI KOMUNALËVE		3,087.66	2,109.51		3,644.26	938.15		21,199.24
Subvencionet per entitetet publike								
Subvencionet per entitetet jopublike								
TOTALI SUBVENCIONEVE								4,168.04
Ndërtesa te banuara								4,168.04
Objekte Arsimore								
Objektet kuturore								
Objektet shendetesore								
Auto Rrugëve								
Rrugët Lokale								
Trotuarët								6,207.00
Kanalizimi								
Ujësjetësi								7,548.50
Furniz Rrymë								
Pajisje speciale mjeksore								
Pajisje tjera								
Mirmbajtja investive								
automjete transporti (autoambulanca)								
Transaksione Kapitale - enti. Publ.								
Pag. neni 39.2 LMFP								
Vendim gjykatë								
TOTALI INVESTIMEVE								
TOTALI PËRGJITHSHËM	20,041.65	235,835.96	87,095.18	8,876.59	197,164.87	7,278.43	3,997.62	898,338.51

Shënime shpjeguese:

Në totalin e pagave të shpenzuara në vlerë prej **754,782.12€** janë nga granti i përgjithshëm, për pagesën e pagave të punëtorëve në listën e pagave, Mëditjet e komiteteve, shtesat e veçanta dhe vendimet gjyqësore nga Kontrata kolektive e Arsimit.

Kategoria e Mallrave dhe shërbimeve të shpenzuara në vlerë prej **104,433.61€** nga granti i përgjithshëm janë 100,909.08€, nga te hyrat vetanake te vitit 2024 janë 201.73€, dhe nga te hyrat vetanake te bartura te vitit 2023 janë 3,322.80€.

Kategoria e Komunalive të shpenzuara në vlerë prej **21,199.24€**, të gjitha janë nga granti i përgjithshëm.


Kategoria e Subvencioneve të shpenzuara në vlerë prej **4,168.04€** nga granti i përgjithshëm janë 3,768.04€, dhe nga te hyrat vetanake te bartura te vitit 2023 janë 400.00€.

Kategoria e Investimeve Kapitale të shpenzuara në vlerë prej **13,755.50€** të gjitha janë nga granti i përgjithshëm.

Shpenzimet sipas Drejtorive dhe progresi me periudhën e njëjtë të viteve paraprake

Shpenzimet Periodike sipas Drejtorive 2021-2024								
Drejtoria	2021	2022	2023	2024	Alokimet TM2 2024	Progr./alokim	Progr. me 2023	
1 Zyra e Kryetarit	48,792.14	57,276.46	44,168.51	52,889.77	96,562.30	54.8%	119.7%	
2 Kuvendi Komunal	27,687.66	25,420.17	63,837.39	68,608.19	73,033.04	93.9%	107.5%	
3 Administratë	57,090.62	87,010.00	88,356.60	63,028.16	122,441.12	51.5%	71.3%	
4 Buxhet dhe Financa	31,291.63	32,163.73	27,866.56	36,498.16	43,014.74	84.9%	131.0%	
5 Zhvillimi Ekonomik	34,103.42	37,324.46	31,743.97	37,075.35	218,340.62	17.0%	116.8%	
6 Sh.publike	65,377.46	61,547.18	52,531.91	50,183.59	166,076.89	30.2%	95.5%	
7 Planifikimi urban	46,957.77	76,364.17	170,956.81	39,765.19	178,409.02	22.3%	23.3%	
8 ZKK	-	3,401.49	2,226.25	3,997.62	3,997.62	100.0%	179.6%	
9 Shëndetsia	140,207.87	131,082.69	158,047.71	203,319.69	235,291.47	86.4%	128.6%	
12 Arsimit	249,168.23	233,374.14	346,508.33	342,972.79	407,531.24	84.2%	99.0%	
Totali Buxhetor	700,676.80	744,964.49	986,244.04	898,338.51	1,544,698.06	58.2%	91.1%	

GRAFIKONTI I SHPENZIMEVE TE DREJTORIVE SI DHE PJESMARRJA NE SHPENZIMIN TOTAL



Në kuadër të Shëndetësisë janë të përfshira: Drejtoria e Shëndetësisë (Administrata), QKMF dhe Shërbimet Sociale.

Në kuadër të Arsimit janë të përfshira: Drejtoria e Arsimit (Administrata), Arsimi fillor dhe Arsimi i mesëm.

❖ **Progresi i shpenzimeve kapitale sipas projekteve për vitin 2024**

Emri i projektit	Kodi i projektit në Thesar	Buxheti 2024	Alokimet TM2/ 2024	Shpenzimet aktuale I - VI / 2024	Struktura në %
	1	2	3	4	5
Bashkefinancim I projekteve	46030	182,451.81	147,942.55	6,207.00	4.20
Rehabilitim I rrugeve Lokale ne qytetin e Junikut	53896	20,000.00	20,000.00	-	-
Kanalizimi I ujrave te zeza lokacioni Moronice Lagja K	53946	9,326.00	9,326.00	7,548.50	80.94
Rregullimi I infrastruktures se oborrit te SHFMU E. Ho	54996	10,000.00	5,000.00	-	-
Ndertimi I rrethojes dhe Rikonstruimi I oborrit te staci	55002	7,000.00	7,000.00	-	-
Ndertimi I Kanaleve te ujitjes Lagja Pepsh, Krraku, Ar	55004	20,000.00	20,000.00	-	-
Vendosja e Kamerave te Sigurise ne Komunen e Jun	55006	25,000.00	22,000.00	-	-
Ndertimi I rrethimit te ndriqimit publik ne rruget lokale jur	55010	20,000.00	10,000.00	-	-
Rregullimi I infrastruktures per deponine e mbeturinat	55012	20,000.00	17,000.00	-	-
Zerimi I Salles se Kuvendit Komunal	55013	13,000.00	13,000.00	-	-
Rekonstruimi I oborrit ne QKMF	55014	10,000.00	10,000.00	-	-
Ndertimi I Sheshit te qendres se Komunes se Junikut	55028	150,000.00	95,000.00	-	-
Rregullimi I hapsirave sportive, rekreative dhe te amb	51003	4,999.99	4,999.99	-	-
Blerja e Automjetit per nevoja te Komunes	53227	210.00	210.00	-	-
Furnizim me gjenrator per Objektivin e Komunes	53232	10,000.00	10,000.00	-	-
Rekonstruimi I rruges Gaxherr Bajraktar	53439	54.00	54.00	-	-
Ndertimi I rrethojes dhe rregullimi I oborrit ne QPS dh	53470	773.00	773.00	-	-
Ndriqimi I hapsirave publike pergjate shtratit te lumit f	53537	10,000.00	10,000.00	-	-
Hapja dhe rregullimi I rruges ne fshatin Gjocaj	53575	1,110.50	1,110.50	-	-
Hapja e rrugeve fushore lokacioni Trojet, Gjocaj etj	53869	355.00	355.00	-	-
Ndertimi I kanalizimit sekondar te ujrave te zeza loka	53877	1,060.89	1,060.89	-	-
Ndertimi I kanaleve te ujitjes topilla Gaxherr	53882	140.00	140.00	-	-
Ndertimi I mureve mbrojtese lokacioni Tofaj dhe Pep	53947	182.25	182.25	-	-
Furnizim me pajisje per analiza Laboratorike ne QKM	53948	1,000.00	1,000.00	-	-
Permiresim I gas kujde zhvill, Giate femijerise	94618	356.50	356.50	-	-
Participim I projekteve	88351	260.98	260.98	-	-
Ngritja e performances	92052	1,834.87	1,834.87	-	-
Total		519,115.79	408,606.53	13,755.50	3.37

*Në Projektin bashkefinancim i projekteve në vlerë prej 6,207.00€ janë të përfshira: Ndërtimi i urës që lidhë Komunen e Junikut me ekofshatrat Gjocaj dhe Jasiq – punët shtese ne bashkefinancim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.

Mjetet e alokuara për Investime kapitale janë 408,606.53€ nga këto burime:

- Grandi 235,728.00€ + Te hyrat vetanake 60,546.74€ + Te hyrat e bartura 109,879.44€ dhe 2,452.35€ nga donacionet.

Realizimi i buxhetit për investime kapitale në total është 13,755.50€, prej tyre (13,755.50€ nga Grandi + 0.00€ nga të hyrat vetanake + 0.00€ nga të hyrat e bartura dhe 0.00€ nga Donacionet).

Progresi i realizimit të investimeve Kapitale karshi mjeteve të alokuara për periudhën Janar – Qershor të vitit 2024 është **3.37%**.

PASOYRA E OBLIGIMEVE TË PA PAGUARA JANAR- QERSHOR 2024

Programet Buxhetore	M&SH	Komunali	Subvencione	Kapitale	Gjithsej	Borgji momental	Pagesa deri me 06/06/24
	5,487.40	2,292.97	-	-	7,780.37		
GJITHSEJ	5,487.40	2,292.97			7,780.37		

Të arkëtueshmet

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2024 € '000
40110	Tatim ne prone	267,999.93
50019	Licenca (Ushtrimi i veprimtarisë)	71,892.18
50408	Qiraja nga objektet publike	2,200.00
Gjithsej		342,092.11

❖ REKAPITULLIMI I INFORMATËS FINANCIARE

Kjo informatë periodike Janar - Qershor / 2024 ka për qëllim informimin detal dhe objektiv për të gjithë treguesit financiar, qofshin pozitive apo negative. Qëllimi kryesor i këtij raporti është që rezultatet pozitive të menaxhimit të këtij buxheti ti forcojmë dhe ti rrisim më tutje, ndërsa treguesit negativë ti eliminojmë gjatë periudhave në vijim. E tërë kjo me qëllim që të jemi sa më të suksesshëm në realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për qëllimet e përcaktuara me planet dinamike të veprimit sipas ligjit mbi Buxhetin.

❖ PLANIFIKIMI BUXHETOR JANAR - QERSHOR 2024

Buxheti fillestar i aprovuar nga Kuvendi Komunal në vlerë **2,199,836.93€** ka pasur ndryshime - rritje në periudhën Janar - Qershor 2024 për: **2,469.85€**, nga mjetet e pranuar nga donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2023. Bartja e te hyrave te pashpenzuara të vitit 2023 te bartura për shpenzim në vitin 2024 në shumë prej **147,963.74€**, Do të thotë buxheti total për vitin 2024 ka vlerën: **2,350,270.52€**.

❖ SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE JANAR - QERSHOR 2024

- **Shpenzimet nga Grandi qeveritar:** Mjetet e alokuara nga ky burim janë 1,319,766.94€, janë shpenzuar 894,413.98€ që do të thotë **67.77%** të mjeteve të alokuara.
- **Shpenzimet nga të hyrat vetanake:** Mjetet e alokuara nga ky burim janë 74,497.53€, janë shpenzuar 201.73 € që do të thotë **0.27%** të mjeteve të alokuara.
- **Shpenzimet nga Mjetet e bartura të viti paraprak:** Mjetet e alokuara nga ky burim janë 147,963.74€, janë shpenzuar 3,722.80 € që do të thotë **2.52%** të mjeteve të alokuara.
- **Shpenzimet nga Donacionet dhe Participimet:** Nga mjetet e pranuar në vlerë 2,469.85€ janë shpenzuar 0.00€ ose **0.00%** të mjeteve të alokuara – pranuar.
- Ne përgjithësi në këtë periudhë Janar - Qershor 2024 vlen të përmendet efikasitet mesatar në menaxhimin e buxhetit (pagesa) **58.16%** e mjeteve të alokuara buxhetore, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023 kemi shpenzime me të ulëta prej **8.91%**.

❖ TË HYRAT BUXHETORE PERIODIKE JANAR - QERSHOR 2024

- **Të Hyrat Vetanake:** Komuna ka realizuar të hyra vetanake në periudhën Janar - Qershor 2024, me donacione 224,931.12€ ose **14.56%** të alokimeve prej 1,544,698.06€.
- **Pengesat që kanë ndikuar në rezultate edhe më të mëdha janë:**
 1. Grandi Qeveritar jo i mjaftueshëm për realizimin e aktiviteteve të parapara nga Komuna dhe kufizimet në planifikimin e shpenzimeve operative.
 2. Obligimet nga Kontrata kolektive e arsimit

Duke pasur parasysh indikatorët e lartë cekur Komuna e Junikut, në Periudhën Janar - Qershor 2024 ka arritur rezultate të mira të cilat u bënë të ditura më lartë.

ZKF
Arten Hamza



Drejtori Buxhet e Financa
Vjollca Qestaj

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK



DATË/A:	12.07.2024
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës, Junik 
NGA/OD/FROM:	znj. Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e KPF-së dhe Kuvendit Komunal shqyrtimin e Raportit të Auditimit të Jashtëm për vitin 2023 dhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

I nderuar,

Bazuar në Rregulloren e Punës për zbatimin e Auditimit dhe Planeve të Veprimit miratuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, kërkojmë që të shqyrtohet Raporti i Auditimit nga ZKA-ja për vitin 2023 si dhe Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Të bashkangjitur në kërkesë gjeni Raportin e Auditimit të Jashtëm dhe Planin e veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve për vitin 2023.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Junikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion I pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Junikut (Junik), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Junikut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Junik kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Junikut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Junikut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Junikut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Junikut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Junikut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Këto gjetje dhe rekomandime kanë të bëjnë me vonesa në urdhërblertje, mangësi në planet e menaxhimit të kontratave, mos regjistrimi i pasurisë nën 1,000€ dhe mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria dhe dobësi në menaxhimin e transferimit të punëtoreve. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me katër (4) rekomandime, prej tyre një (1) rekomandim i ri dhe tri (3) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Çështja A1 - Dobësi në menaxhimin e transferimit të punëtorëve

Gjetja

Sipas nenit 6 të Ligjit të pagave, paga përfitohet për punën e kryer me orar të plotë apo punën me orar të pjesshëm që konsiderohet si punë me orar të plotë, në një funksion apo pozitë të caktuar që përcaktohet nga grupi dhe klasa e pagës së cilës i përket funksioni apo pozita, ashtu siç është përcaktuar në shtojcat e këtij ligji.

Nga testimi ka rezultuar se komuna e Junikut gjatë vitit 2023, kishte paguar paga për 3 zjarrëfikës dhe 5 pyllëtar të cilët nuk kanë ofruar shërbim për komunën.

Sipas zyrtarëve të komunës këtyre punonjësve paga iu është paguar nga komuna, mirëpo ata nuk janë evidentuar në regjistrin e vijueshmërisë në punë të komunës. Rrjedhimisht ata nuk janë evidentuar në regjistrat e komunës për vijueshmërinë në punë dhe as nuk kanë bërë as kërkesa për pushim dhe të tjera në komunë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos menaxhimit të duhur të vendimit për transferrin e këtyre kategorive të punonjësve.

Ndikimi

Dobësit në transferrin e punonjësve nga një institucion në tjetrin, mund të ndikojnë që pagesa e pagave dhe kompenzimeve të tjera të bëhen pa e marrë shërbimin për të cilin janë angazhuar. Mos evidentimi i punonjësve në regjistrin e vijueshmërisë në punë rezulton me pagesë të pagave pa ofruar shërbime në njërin anë, ndërsa në anën tjetër e pengon komunën që të rekrutojë punonjës për vendet e punës nga të cilat nuk merr shërbime.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të marrë veprime që punonjësit e transferuar në institucionet tjera të largohen nga lista e pagave të punonjësve të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Çështja B1 - Urdhërblerja me vonesë

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013, neni 22, përcakton hapat për procedim të pagesave, ku fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje (zotimi i mjeteve), të procedohet urdhërblerja, pastaj pranimi i mallit, pastaj pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Gjatë testimi të pagesave kemi vërejtur që një urdhërblerja ishte lëshuar tetë (8) ditë pas pranimit të faturës., vlera e të cilës ishte 19,790€.

Kjo ka ndodh si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit dhe ekzekutimit të pagesave.

Ndikimi Procedimi i urdhërblereve me vonesë vështirëson zbatimin e drejtë të kontratave dhe krijon paqartësi rreth urdhërësive për furnizim, shërbime apo fillim të punëve.

Rekomandimi B1 Nxjerrja e urdhërblereve pas nënshkrimit të kontratës. Verifikimi i disponueshmërisë së mjeteve financiare para përfundimit të punëve apo shërbimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mangësi në planet e menaxhimit të kontratave

Gjetja Rregullorja për prokurim public Nr.01/2022, neni 70, paragrafi 11, thotë plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të Menaxherit të Kontratës nga ana e AK dhe menaxherit të kontratës nga ana e Operatorit Ekonomik.

Gjatë testimi të planeve për menaxhimin e kontratës kemi vërejtur se dy plane për menaxhimin e kontratës nuk janë nënshkruar nga menaxheri i kontratës së operatorit ekonomik.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxheret e kontratave nuk i kishin zbatuar përgjegjësitë e tyre.

Ndikimi Mangësitë e identifikuar në nënshkrimin e planit për menaxhimin e kontratave rrezikojnë përmbushjen e kontratave sipas kushteve të parapara.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë përpilimin dhe nënshkrimin e planit të menaxhimit të kontratës dhe nënshkrimin e tyre nga të dyja palët në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kontratës sipas kushteve të parapara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Çështja B3 - Mos regjistrimi i pasurisë nën 1,000€ dhe mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria

Gjetja

Rregullorja MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.1. përcakton se, "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnojë regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në baze të planit kontabël. Po ashtu neni 6.3. përcakton se, "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Nga testimet tona ka rezultuar se blerjet e vitit 2023, për pasuritë nën 1,000€, në vlerë 8,745€, nuk ishin regjistruar në regjistrat kontabël. Po ashtu kemi vërejtur që komuna nuk e ka funksionalizuar sistemin e-pasuria.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në menaxhimin e pasurisë dhe pengesave në funksionalizimin e sistemit e-pasuria.

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurisë nën 1,000€ dhe mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, mund të ndikon në humbjen a po tjetërsimin e pasurisë dhe prezantimin e informatave jo të plota në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se pasuritë nën 1,000€, regjistrohen në regjistrat kontabël të pasurive dhe të ndërmarr veprime për funksionalizimin e sistemit e-pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikeve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,877,346	2,346,948	2,163,218	1,683,346	1,459,692
Grante Qeveritare - Buxheti	1,718,016	1,990,004	1,949,109	1,416,782	1,370,202
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	21,430	5,156
Të bartura nga viti i kaluar	0	195,144	102,629	91,910	31,830
Të hyrat vetanake	159,330	159,330	111,480	153,225	52,504
Donacionet vendore	0	18	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	2,452	0	0	0


Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 469,602€. Kjo rritje është rezultat i grantit qeveritar, të hyrave të bartura nga viti i kaluar dhe financimi nga donacionet vendore dhe të jashtme. Në vitin 2023, Komuna e Junikut ka shpenzuar 92% të buxhetit final ose 2,163,218€, me një rritje prej 4% krahasuar me vitin 2022. Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,877,346	2,346,948	2,163,218	1,683,346	1,459,692
Pagat dhe mëditjet	1,170,906	1,442,894	1,442,894	1,102,859	1,114,762
Mallrat dhe shërbimet	236,740	276,367	223,589	216,446	172,167
Komunalitë	37,700	37,700	31,883	32,053	29,878
Subvencionet dhe transferet	52,000	52,064	51,664	58,886	21,550
Investimet Kapitale	380,000	537,923	413,188	273,101	121,334

- Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, janë dhënë si në vijim:
- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 271,987€. Kjo rritje ishte prej rishikimit të buxhetit. Shpenzimet në këtë kategori ishin 100% e buxhetit;
 - Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 39,627 si rezultat i të hyrave vetanake. Në këtë kategori shpenzimet ishin 81% e buxhetit;
 - Buxheti final për shërbimet komunale ka mbetur njësoj me atë fillestar 37,700€. Të kjo kategori, shpenzimi i buxhetit ishte 85%;
 - Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte njëjtë krahasuar me atë fillestar. Shpenzimet ishin 99% e buxhetit; dhe
 - Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 157,923€. Kjo rritje ishte prej buxhetit dhe të hyrave vetanake të bartura dhe aktuale. Shpenzimet ishin 77% e buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga komuna në 2023 ishin në vlerë 159,872€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja etj. Në këtë vit të hyrat krahasuar me vitin 2022, ishin më të ulëta për 53% apo për 183,522 €.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	159,330	159,330	159,872	343,394	139,621
Të hyrat tatimore	102,020	102,020	113,500	96,238	89,599
Të hyrat jo tatimore	57,311	57,311	45,864	247,156	50,022
Të hyrat tjera	0	0	508		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak



Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr.	Pika e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Vendimet marrë nga viti	Zbatimi
1.	Çështjet e përbashkëta	Nxjerrja e udhërblerjeve pas nënshkrimit të kontratës. Verifikimi i disponueshmërisë së mjeteve financiare para përfundimit të puënve apo shërbimeve.	Nga testimet tona kemi hasur në një urdhërblerje të lëshuar pas datës së faturës.	Nuk ka filluar zbatim
2.	Çështjet e përbashkëta	Ne rekomandojmë menaxhimentin që të adresojë këtë çështje në mënyrë të menjëhershme dhe të marrë masat e duhura për të përmirësuar situatën. Nëse është e nevojshme, të ofrojë mbështetje dhe trajnime shtesë për menaxherët e kontratave.	Nga testimet tona kemi hasur në dy plane të menaxhimit të kontratave që nuk janë nënshkruar nga menaxheri i kontratës së operatorit ekonomik.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj që pasuria nën 1,000€ të regjistrohet në sistemin e-pasuria në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	Nga testimet tona kemi gjetur pasuri të paregjistruara në vitin 2023.	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AltiAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditimit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyren e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Junikut, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti").
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit si dhe:
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afazet kohore dhe statin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Kuzhdi Shehu
Kryetar i Komunës së Junikut

Data: 29. Maj, 2024, Junik.

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

"E përhapur" është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.


Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënime fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RÉPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Për : Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z. Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunës së Junikut

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra
Kombëtare e Auditimit

Nr.	Komponente dhe auditimi (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Çështja A1 – Dobësi në menaxhimin e transferimit të punëtoreve	<p>Sipas nenit 6 të Ligjit të pagave, paga përfitohet për punën e kryer me orar të plotë apo punën me orar të pjesshëm që konsiderohet si punë me orar të plotë, në një funksion apo pozitë të caktuar që përcaktohet nga grupi dhe klasa e pagës së cilës i përket funksioni apo pozita, ashtu siç është përcaktuar në shtojcat e këtij ligji.</p> <p>Nga testimi ka rezultuar se komuna e Junikut gjatë vitit 2023, kishte paguar paga për 3 zjarrfikës dhe 5 pyllëtar të cilët nuk kanë ofruar shërbim për komunën.</p> <p>Sipas zyrtarëve të komunës këtyre punonjësve paga iu është paguar nga komuna, mirëpo ata nuk janë evidentuar në regjistrin e vijueshmërisë në punë të komunës. Rrjedhimisht ata nuk janë evidentuar në regjistrat e komunës për vijueshmërinë në punë dhe as nuk kanë bërë as kërkesa për pushim dhe të tjera në komunë.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i mos menaxhimit të duhur të vendimit për transferimin e këtyre kategorive të punonjësve.</p>	<p>Rekomandimi A1</p> <p>Kryetari duhet të marr veprime që punonjësit e transferuar në institucionet tjera të largohen nga lista e pagave të punonjësve të komunës.</p>	<p>1. Kërkesë përfaqësuesve përgjegjës për mundësinë e transferimit</p> <p>2. Aprovimi nga institucionet përgjegjëse për transferim të stafit</p> <p>3. Barja e stafit tek institucionet përkatëse</p>	<p>ZKA</p> <p>Udhëheqësi i personelit DSHPIM</p> <p>DZHE</p> <p>DBF</p>	31.01.2025	<p>Komentet</p> <p>ynë është se pas hartimit të planit të veprimit zbatimi i këtij rekoma ndimi nuk varet nga Komuna e Junikut por nga Niveli Qendror</p>
2	Çështja B1 - Urdhërblerja me vonesë	<p>Rregulla financiare Nr.01/2013, neni 22, përcakton hapat për procedim të pagesave, ku fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje (zotimi i mjeteve), të</p>	<p>Rekomandimi B1</p> <p>Kryetari të sigurojë përmirësimin e</p>	<p>1. Nxjerja e vendimit për kushtëzimin e</p>	<p>ZKA</p> <p>Drejtorat e drejtorive ZKF</p>	01.08.2024	

3	<p>Çështja B2 – Mangësi në planet e menaxhimit të kontratave</p> <p>procedohet urdhërblerja, pastaj pranimi i mallit, pastaj pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.</p> <p>Gjatë testimi të pagesave kemi vërejtur që një urdhërblerja ishte lëshuar tetë (8) ditë pas pranimit të faturës, vlera e tërës ishte 19,790€.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit dhe ekzekutimit të pagesave.</p>	<p>kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.</p>	<p>pranimit të faturës</p> <p>2. Nxjerrja e urdhërbljeve pas nënshkrimit të kontratës.</p> <p>3. Verifikimi i disponueshmërisë së mjeteve financiare para perfundimit të punimeve apo shërbimeve.</p>	<p>Zyrtari përgjegjës i prokurimit Menaxherat e kontratave Mbikqyresit i menaxherit të kontratës</p>	
3	<p>Rregullorja për prokurim public Nr.01/2022, neni 70, paragrafi 11, thotë plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të Menaxherit të Kontratës nga ana e AK dhe menaxherit të kontratës nga ana e Operatorit Ekonomik.</p> <p>Gjatë testimi të planeve për menaxhimin e kontratës kemi vërejtur se dy plane për menaxhimin e kontratës nuk janë nënshkruar nga menaxheri i kontratës së operatorit ekonomik. Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxheret e kontratave nuk i kishin zbatuar përgjegjësitë e tyre.</p>	<p>Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë përpilimin dhe nënshkrimin e planit të menaxhimit të kontratës dhe nënshkrimin e tyre nga të dyja palët në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kontratës sipas kushteve të parapara.</p>	<p>1. Organizimi i trajnimit për menaxherët e kontratave</p> <p>2. Raportimi periodik gjatë implementimit të kontratave nga menaxherët e kontratave</p> <p>3. Mbikqyrja e implementimit të modulit për menaxhimin e kontratave në sistem të</p>	<p>ZKA Drejtoret drejtorive Zyrtari përgjegjës i prokurimit Menaxherat e kontratave Mbikqyresit i menaxherit të kontratës</p>	31.12.2024

4	<p>Çështja B3 - Mos regjistrimi i pasurisë nën 1,000€ dhe mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria</p>	<p>Rregullorja MF-NR. 02/2013 per menaxhimin e pasurise jo financiare ne organizatat buxhetore, Neni 6.1. percakton se, "Çdo organizatë buxhetore duhet te krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare qe i ka ne menaxhimin e saj. Regjistri duhet te mbahet ndaras per çdo pasuri dhe në forme të agreguar sipas kategorive të klasifikuara ne baze të planit kontabel. Po ashtu neni 6.3. percakton se, "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet ne SIMFK ndersa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet te regjistrohet ne sistemin "e-pasuria".</p> <p>Nga testimet tona ka rezultuar se blerjet e vitit 2023, për pasuritë nën 1,000€, në vlerë 8,745€, nuk ishin regjistruar në regjistrat kontabel. Po ashtu kemi vërejtur që komuna nuk e ka funksionalizuar sistemin e-pasuria.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në menaxhimin e pasurisë dhe pengesave në funksionalizimi e sistemit e-pasuria.</p>	<p>Rekomandimi B3 Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se pasuritë nën 1,000€, regjistrohen në regjistrat kontabel të pasurive dhe të ndërmarr veprime për funksionalizimin e sistemit e-pasuria.</p>	<p>prokurimit elektronik 1. Rekrutimi i zyrtarit të pasurisë dhe zyrtarit të logjistikës 2. Trajtimi i personave përgjegjës ne sistemin E-pasuria 3. Azhurnimi i regjistrimit të pasurisë sipas vlerësimit të komisionit dhe sipas blerjeve gjatë vitit. 4. Përmirësimi i mirëmbajtjes dhe azhurnimi i sistemit E-pasuria</p>	<p>ZKA Drejtoret e Drejtorive, Drejtoria per buxhet dhe financa ZKF Zyrtarja e pasurise Zyrtari i logjistikes.</p>	<p>10.01.2025</p>
---	---	--	--	---	--	-------------------

Kryetar i Komunës së Junikut

Ruzhdi Shehu



Data: 17.07.2024

